

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: **Gjykatësin e Procedurës Paraprake**
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon
Parashtrues: Mbrojtësi i Rexhep Selimit
Data: 27 nëntor 2020
Gjuha: Anglishte
Klasifikimi: Publik

Njoftim i Mbrojtjes në lidhje me rregullën109(C)

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësi i Hashim Thaçit
Dejvid Hupër

Mbrojtësi i Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtësi i Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtësja e Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

1. Në përputhje me udhëzimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake,¹ Mbrojtja e z. Rexhep Selimi njofton Gjykatësin e Procedurës Paraprake se nuk ka qenë në gjendje të arrijë marrëveshje me ZPS-në në lidhje me përmbushjen e obligimeve të ZPS-së sipas rregullës 109(C).

2. Më 24 nëntor 2020, Mbrojtja i shkroi ZPS-së duke propozuar si vijon:

“1. Gjatë secilës nxjerrje të informacionit, pala nxjerrëse bën të ditur, aq sa është e realizueshme dhe përmes “Kategorive të provave” në *Legal Workflow*, se a ka të bëjë prova në fjalë lidhje me krimet bazë, elementet kontekstuale, sjelljen e të akuzuarit ose, sipas rastit, prova që do të paraqiten nga Prokurori i Specializuar. Kjo vlen për të gjitha provat e nxjerra. Gjithashtu, secila prej këtyre kategorive do të ndahet në këto nënkategori, ku mund të zgjidhen disa:

- a. Krimet bazë
 - i. Lloji i krimit, p.sh. arrestimet dhe ndalimet e paligjshme arbitrare
 1. Vendngjarja e krimit
- b. Elementet kontekstuale
 - i. Krimet kundër njerëzimit (Aktakuza, paragrafët 16-17)
 - ii. Krimet e luftës (Aktakuza, paragrafët 18-31)
- c. Veprimet e të akuzuarit
 - i. Ndërmarrje e përbashkët kriminale (Aktakuza, paragrafët 32-52)
 - ii. Përgjegjësia eprore (Aktakuza, paragrafët 53-55)
- d. Provat që do të paraqiten
 - i. Të lidhura me elementin përkatës të provave

2. Gjithashtu, dhe në lidhje vetëm me materialin sipas rregullës 102(1)(b) për ZPS-në dhe materialin sipas rregullës 104(1), (5) dhe (6) për Mbrojtjen, do të jepet tabela në formën në të cilën është bashkëngjitur më herët nga ZPS-ja, e cila do të përpilohet sipas referencave që përmbajnë dosjet paraprake të palëve (nëse do të ketë) si dhe materiali tjetër i nxjerrë sipas këtyre rregullave.

3. Në mesazhin e vet elektronik më 25 nëntor, ZPS-ja e refuzoi pjesën 1 të propozimit të Mbrojtjes me arsyetimin se “nënkategoritë e propozuara janë të pamundshme për çdo paketë të informacionit të nxjerrë” dhe se “ky veprim do

¹ Prokurori k. *Thaçit e të tjerëve*, Vendimi kornizë mbi nxjertjen e provave dhe çështje lidhur me to, KSC-BC-2020-06/F00099, 23 nëntor 2020, para. 80.

të kërkonte tepër kohë dhe do ta vononte në mënyrë të konsiderueshme procesin e nxjerrjes së informacionit.” Me gjithë komunikimet e mëtejshme, nuk u arrit marrëveshje midis ZPS-së dhe Mbrojtjes së Selimit për këtë pikë.

4. Mbrojtja mendon se fraza “kategorizon informacionin në përputhje me akuzat e aktakuzës, duke iu referuar veprave penale konkrete” në rregullën 109(C) bën të nevojshme nënkategoritë e propozuara më 24 nëntor. Mbrojtja nuk e kupton se pse nuk mund të bëhet ky nënkategorizim për çdo paketë të informacionit të nxjerrë përmes *Legal Workflow*. Koha shtesë që do të nevojitet tani gjatë përgatitjes së paketave të nxjerrjes së informacionit nga ZPS-ja do të kursejë kohë më vonë kur ZPS-ja të përgatisë tabelën në momentin e dorëzimit të dosjes paraprake të Prokurorisë.
5. Kjo gjithashtu do ta ndihmonte shumë Mbrojtjen dhe Gjykatësin e Procedurës Paraprake për të kuptuar dhe vlerësuar në kohë reale rëndësinë e materialit të paraqitur gjatë nxjerrjes së informacionit nga ZPS-ja. Duke e udhëzuar ZPS-në që ta kategorizojë nxjerrjen e informacionit në këtë mënyrë përmes *Legal Workflow*, palët do të jenë në gjendje që të krijojnë thjesht dhe shpejt dhe në vijimësi tabela të kategorizimit gjatë zhvillimit të procesit. Kjo do të përmirësojë dhe inkurajojë administrimin e mirë të çështjes, duke i lejuar palët që të përditësojnë tabelat dhe të përcjellin nxjerrjen e informacionit në mënyrë të kuptueshme.

E paraqitur me respekt më 27 nëntor 2020,

/nënshkrimi

/nënshkrimi/

DEJVID JANG
Mbrojtësi i Rexhep Selimit

XHEFRI ROBERTS /GEOFFREY ROBERTS/
Bashkëmbrojtësi i Rexhep Selimit